



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1278/1 prot.

Tiranë, më 30 . 09 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 258, datë 30 . 09 . 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 191 Regj., datë 16.09.2024, të shtetasit A. H, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjeve filozofike”, gjendjes arsimore” dhe “moshës”, nga ana e Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë/ASHSH-së.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,<sup>2</sup>

**K O N S T A T O I:**

**I. Pretendimet sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë KMD-së, nga ana e subjektit ankues, ndër të tjera, parashtrohet si vijon:

*“Jam i punësuar si kërkues shkencor në Institutin e Historisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Vitin e kaluar fitova bursën e Fondacionit Humboldt, me statusin e kërkuesit shkencor ekspert dhe duke filluar nga 3 qershori i këtij viti deri në 31 mars të vitit 2026, unë jam bursist Humboldt në Qendrën Carl Duisberg në Mynih dhe në Institutin Lajbnic për Studimet e Evropës Lindore dhe Juglindore në Regensburg.*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

*Prej fundit të janarit të këtij viti, kur kam dorëzuar kërkesën për lëvizjen time të përkohshme në Gjermani, Akt-Marrëveshja me Akademinë e Shkencave m'u paraqit për nënshkrim në datën 24 maj. Duke qenë se ishin ditët e fundit para largimit, nuk kisha kohë që ta studioja përmbajtjen dhe e nënshkrova.*

*Pas një qëmtimi të hollësishëm vura re se asnjë nga nenet e akteve ligjore dhe nënligjore të cituara në dokument nuk vlejnë për rastin tim.*

*I jam drejtuar me shkrim disa herë instancave përgjegjëse të ASHSH-së, pa marrë asnjëherë asnjë përgjigje. Ajo që dua të theksoj është se, pa u mbështetur në asnjë ligj, mua më kanë caktuar një rrogë në masën 20%, ndërkohë që në Gjermani do të bëj pikërisht projektin kërkimor të caktuar dhe miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë.*

*Përpos kësaj, sigurimet shoqërore, në mënyrë të kundërligjshme, më janë caktuar jo mbi bazën e rrogës time bazë, por mbi bazën e rrogës minimale, që është 40 000 lekë.*

*Pasi jam ankuar në Zyrën e Bashkëqeverisjes, Zyra e Tatim-Taksave ka thirrur personat përgjegjës të ASHSH-së dhe i ka këshilluar që, në përputhje me ligjin, të më japin sigurimet shoqërore mbi bazën e rrogës së plotë, por ASHSH-ja, jo vetëm që nuk më ka paguar sigurimet shoqërore të plota, por për muajin qershor nuk më kanë paguar fare as sigurimet, as rrogën. Kurse për muajin korrik, Kancelari i këtij Institucioni ka derdhur në bankë shumën e dy rrogave prej 20% të pagës bazë mujore. Për rrjedhojë, duke u kapërcyer shuma prej 40 000 lekësh që është ajo e rrogës minimale, ai ka derdhur edhe sigurimet shoqërore për muajin korrik. Për muajin qershor unë rezultoj pa sigurime dhe pa rrogë, pra, dal të jem i papunë.*

*Dua të theksoj se në biseda private, nga kancelari dhe anëtarë të ASHSH-së më është thënë se “do marrësh 20% të rrogës sepse nuk po të dërgojmë ne”, duke më vënë në dukje se, “nuk mund të marrësh dy rroga njëkohësisht”. Unë nuk po marr dy rroga, por po marr një bursë nga Fondacioni Humboldt. Ky Fondacion nuk jep bursa që bursistët “të bëjnë lëkë”, sikundër mendojnë funksionarët e Administratës së ASHSH-së, por japin bursa për të mbuluar nevojat jetike në mënyrë që bursisti të ketë të ardhura të nevojshme për të kryer si duhet kërkimin shkencor. Bursat nuk janë forma shpërblimi dhe as forma page, por mbështetje financiare për mbarëvajtjen e shërbimit tekniko-shkencor për shfrytëzimin maksimal të infrastrukturës së institucioneve akademike gjermane, me qëllim përparimin e shkencës.*

*Dyshoj se ky qëndrim diskriminues, që kryhet në këndërshtim me ligjet dhe që autoritetet drejtuese të ASHSH-së vijojnë ta mbajnë me këmbëngulje pavarësisht sugjerimeve që i japin institucionet shtetërore kompetente, ushqehet nga mëri që persona të caktuar në pozicione drejtuese të ASHSH-së, kanë ndaj meje si pasojë e disa arikujve kritikë që kam bërë më parë ndaj Akademisë së Shkencave. Unë kam ushtruar të drejtën time kushtetuese dhe lirisë së fjalës që më garantohet prej dokumentit themeltar të shtetit dhe kjo nuk është pritur mirë në radhët e autoriteteve drejtuese të ASHSH-së. Përpos të tjerash, sikundër edhe formula “nuk të kemi dërguar ne”, tregon moszabtimin e ligjit dhe favoret dhe mbrojtjen që studiuesit gëzojnë nga shteti. Janë këta të fundit*

*që dërgojnë ose jo studiuesit për specializime, gjë që mban gjallë sistemin e klientelave dhe favoreve. Kur nuk je pjesë e rrjetit dhe kur ke rezultate që sfidojnë monopolin e drejtuesve mbi fushën studimore, menjëherë i nënshtroresh diskriminimit sikurse është dhe rasti im.*

*Përpos kësaj, duke qenë se fusha ime kërkimore përqendrohet te periudha komuniste, drejtuesit e tanishëm të ASHSH-së, janë tejet të ndjeshëm pasi kanë qenë vetë aktorë në ato vite, si dhe janë formuar intelektualisht me handikape tejet të mëdha intelektuale. Jo vetëm që unë kam botuar dy monografi studimore jashtë Shqipërisë-një në Angli dhe një në SHBA, me një të tretë që do të botohet në Angli në pranverën e vitit tjetër – por edhe formimi im intelektual në Perëndim si dhe lëvizshmëria ime në institute kërkimore të huaja ngjall jo pak zili dhe smirë tek drejtuesit e ASHSH-së. Duke dashur të jenë ata etërit e dijes dhe monopolin mbi botimet ta përdorin për të legjitimuar pushtetin e tyre, atëherë ata godasin këdo që dëshmon që ka rrugë të tjera drejt suksesit, rrugë këto që nuk kalojnë përmes Kryesisë. Për rrjedhojë, jam vendosur në shënjestrën e arbitraritetit të kësaj Kryesie.*

*Akt-Marrëveshja e përdorur për mua është marrë e kopjuar nga raste të ngjashme paraprake që janë zbatuar në Akademinë e Studimeve Albanologjike, e cila, deri në dhjetor të vitit 2023, gjendej në varësinë institucionale të Ministrisë së Arsimit, ka kaluar në varësinë e Akademisë së Shkencave. Duke qenë një kopjim shabllon, Akt-Marrëveshja nuk i përgjigjet as rastit tim, dhe as kornizës së re institucionale. Përdorimi i modeleve të vjetra, mosmbështetja e Akt-Marrëveshjes bë ligje dhe abuzimi deri edhe me këtë Akt-Marrëveshje, janë forma të ushtrimit arbitrar të pushtetit nga ana e drejtuesve të ASHSH-së dhe diskriminim ndaj personit tim”.*

Në mbyllje të ankesës së tij pranë Komisionerit subjekti ankues, ka kërkuar: “Konstatimin e diskriminimit dhe vënien e drejtësisë në vend, sa i takon përdorimit të modeleve të vjetra të Akt-Marrëveshjes së nënshkruar mes tij dhe ASHSH-së, nga ana e drejtuesve të këtij Insitucioni”.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dherespektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore,

*predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr. 191 Regj., datë 16.09.2024, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj.*

Për rrjedhojë, me anë të e-mailit datë 18.09.2024, Komisioneri iu drejtua ankuesit duke i kërkuar plotësimin e ankesës, veçanërisht në drejtim të provueshëmrisë së shkaqeve të pretenduara, lidhjes me trajtimin e padrejtë a të pabarabartë të pretenduar, si dhe të pasjes dijeni të tyre nga ana e subjektit kundër të cilit ka depozituar ankesën pranë KMD-së<sup>3</sup>.

Në vijim nuk u depozitua asnjë parashtrim, provë a fakt nga ana e ankuesit. Për rrjedhojë, Komisioneri, ka analizuar parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti ankues, bashkëlidhur ankesës.

***Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, vëren se:***

---

<sup>3</sup> Komunikimi u realizua në adresën elektronike që subjekti kishte komunikuar më parë me specialistet e Zyrës së Pritjes së Ankesave/KMD, përmbajtja e të cilit është depozituar në dosjen e ankuesit pranë KMD-së, në cilësi prove.

Nëpërmjet shkresës me nr. 515/1 prot., datë 24.05.2024, me titull : “Akt-Marrëveshje”, me datë 24.05.2024 është lidhur një marrëveshje, mes Akademisë së Shkencave<sup>4</sup> dhe ankuesit, z. A. H, në të cilën përcaktohet si më poshtë vijon:

*“Lidhet kjo marrëveshje ku përcaktohen të drejtat e detyrimit konform legjislacionit në fuqi, ndërmjet palëve:*

*Akademisë së Shkencave, me kryetar Akad. S. Gj dhe z. A. H, Ph.D, kërkues shkencor në Departamentin e Historisë Bashkëkohore në Institutin e Historisë, fitues i bursës Humboldt që jepet prej Qeverisë Federale të Gjermanisë, për të kryer studimin me temë: “E kuqja dhe e zeza: ateizmi, feja dhe moderniteti në Shqipërinë komuniste”, në periudhën 3 qershor 2024 – 31 mars 2026, i cili ka miratimin nga drejtori i Institutit të Historisë dhe Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë, me vendimin nr. 3, datë 01.02.2024, për t’u larguar e punuar në Institutin Lajbnic për Studimin e Evropës Lindore dhe Juglindore në Regensburg (Leibniz Institut fuer Ost und Sudosteuroopa Forschung) Gjermani.*

*Sa më sipër:*

- 1. Akademia e Shkencave, mbështetur në VKM nr. 367, datë 03.07.1995 “Për administrimin e bursave për studime pasuniversitare, shkolla të mesme dhe për studime, specializime e kualifikime pasuniversitare jashtë shtetit”, pika 10, germa a), merr përsipër t’i ruajë vendin e punës z. A. H, për periudhën 3 qershor 2024 – 31 mars 2026, që përkon me kohën e largimit të tij jashtë vendit, në kuadër të bursës së fituar.*
- 2. Trajtimi financiar për z. A. H të bëhet në masën 20% të pagës, mbështetur në VKM nr. 367, datë 03.07.1995 “Për administrimin e bursave për studime pasuniversitare, shkolla të mesme dhe për studime, specializime e kualifikime pasuniversitare jashtë shtetit”, pika 10, germa a); VKM nr. 295, datë 18.07.1964 “Për dhënin e shpërblimit familjeve të punonjësve dhe ushtarakëve aktivë që dërgohen jashtë shtetit për studim e specializim”, i ndryshuar, pika 1, germa a), si dhe në certifikatën familjare.*
- 3. Mbështetur në VKM nr. 367, datë 03.07.1995 “Për administrimin e bursave për studime pasuniversitare, shkolla të mesme dhe për studime, specializime e kualifikime pasuniversitare jashtë shtetit”, pika 10/b, Statutin e ASH-së, e pas përfundimit të afateve të përcaktuara, z. A. H përgatit një relacion me shkrim, të detajuar në lidhje me realizimin e objektivave. Ky relacion duhet të miratohet nga drejtuesi i departamentit dhe nga drejtuesi i institutit e më pas të paraqitet te kryetari i ASH-së për miratim. Pas miratimit përfundimtar, ky dokument depozitohet pranë burimeve njerëzore dhe shërben për fillimin e punës pranë departamentit të historisë bashkëkohore.*

---

<sup>4</sup> Në vijim referuar me akronimet ASHSH dhe ASH.

4. *Mospërmbushja e detyrimit sipërcituar, do të sjellë pasoja administrative për punonjës të kërkimor-shkencor, z. A. H.*
5. *Në rast se projekti kërkimor-shkencor ka nevojë të vazhdojë më tej, e cila përkon me afatin e zgjatjes së periudhës së bursës, duhet nënshkruar një akt marrëveshje e re mes palëve.”*

Akt -Marrëveshja e mësipërme është nënshkruar nga ankuesi, në cilësinë e kërkuesit shkencor, dhe z. S. Gj në tagrin e personit përfaqësues të ASH-së dhe përbëhet gjithsej nga 5 pika.

Kërkimi i ankuesit pranë KMD-së, ka të bëjë pikërisht me ndryshimin e përmbajtjes së kësaj Akt-Marrëveshjeje (pikës 2, të saj), duke pretenduar se nga ASHSH-ja, është përdorur një model i vjetër, i kopjuar shabllon, i pa përditësuar me ndryshimet e fundit të situatës faktike e ligjore të ASH-së.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

***Pas analizimit sa më sipër, si dhe akteve të depozituara nga subjekti ankues, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e LMD-së, bazuar në arsyetimin vijues:***

Së pari, lidhur me identifikimin e provueshmërinë e shkaqeve, bazuar në të cilat ankuesi pretendon se është diskriminuar nga Kryesia e ASHSH-së.

Komisioneri vëren se, ankuesi kur citon shkaqet e “*bindjeve filozofike*<sup>5</sup>”, *gjendjes arsimore*<sup>6</sup>” dhe “*moshës*<sup>7</sup>”, për të cilat pretendon diskriminimin nga ana e ASH-së, evidenton faktin se këto shkaqe ai i lidh me *pasojat* që i vijnë nga mosveprimi i këtij institucioni lidhur me përfitimin nga ana e tij të pagës dhe sigurimeve shoqërore, në masën e pretenduar, çka është formalizuar nëpërmjet Akt-Marrëveshjes së nënshkruar mes tyre, dhe jo me faktin që ky veprim ka ardhur pikërisht për shkak se ai posedon këto cilësi apo shkaqe apo të jetë motivuar prej tyre.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vëren se, *parimisht*, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim

<sup>5</sup> Ankuesi nuk ka depozituar shpjegime, fakte e prova lidhur me provueshmërinë e këtij shkak apo të situatës se si lidhet trajtimi i tij nga ASHSH-ja, me këtë shkak.

<sup>6</sup> Ankuesi nuk ka depozituar shpjegime, fakte e prova lidhur me provueshmërinë e këtij shkak apo të situatës se si lidhet trajtimi i tij nga ASHSH-ja, me këtë shkak.

<sup>7</sup> Ankuesi nuk ka depozituar shpjegime, fakte e prova lidhur me faktin se si ky shkak lidhet apo ka afektuar sjelljen e ASHSH-së ndaj tij, sa i takon pikës 2, të Akt-Marrëveshjes, objekt të kësaj ankese.

dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë mosha e ankuesit, gjendja arsimore dhe bindjet filozofike të tij.

Pala ankuese nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të presumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të ASHSH-së që të jenë motivuar nga këto shkaqe.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, ndodhemi përpara rastit, kur ankuesi ka pretenduar për paligjshmëri dhe mosveprim të ASH-së konform parashikimeve ligjore (pa përcaktuar se cili ligj apo akt nënligjor specifikisht është shkelur).

Së dyti, lidhur me identifikimin nga ana e ankuesit, të subjektit që pretendohet se ka kryer sjelljen apo veprimet diskriminuese, evidentohet se:

Ankesën e paraqitur tek KMD, ankuesi e ka kundërdrejtuar ndaj Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ligji nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 11, pikat 1,2, të tij, përcaktohet se:

*“1. Kryesia është organ ekzekutiv i Akademisë.*

*2. Kryesia përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve.”*

Neni 12, i këtij Ligji, në pikat 1,2,3, të tij, përcakton se cilat janë detyrat dhe kompetencat e Kryesisë, duke cituar se:

*“1. Detyrat dhe kompetencat e Kryesisë janë:*

*a) organizon dhe drejton Akademinë në bazë e në zbatim të këtij ligji, statutit të saj dhe vendimeve të Asamblesë;*

*b) ndjek dhe organizon punën e seksioneve, komisioneve, si dhe të njësive të ngritura pranë Akademisë;*

*c) organizon dhe drejton punën e administratës së Akademisë, përfshirë edhe entin botues, sipas rregullores së brendshme të funksionimit të saj;*

*ç) përgatit projektprogramin dhe projektbuxhetin;*

*d) përgatit mbledhjet e Asamblesë;*

*dh) përgatit raportin vjetor.*

*2. Për kryerjen e detyrave të saj, Kryesia nxjerr vendime të brendshme. Vendimet e brendshme merren me shumicë të thjeshtë. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit është përcaktuese.*

*3. Detyrat e zëvendëskryetarit, sekretarit shkencor dhe drejtuesve të seksioneve përcaktohen në Statutin e Akademisë.”*

Të njëjtat përcaktime ligjore për Kryesinë e Akademisë parashikohen edhe në nenin 13 (kreu III), dhe nenin 30, të Statutit të ASH-së, miratuar me Vendimin e Asamblesë së ASH-së, me nr. 22, datë 18.10.2019, të ndryshuar<sup>8</sup>.

Ky akt rregullator i ASH-së, ("Statuti"), ka për qëllim të përcaktojë rregullat, procedurat dhe kriteret më të hollësishme për funksionimin e ASH-së e të organeve dhe strukturave të saj, në zbatim të ligjit të ASH-së e në plotësim të tij, si dhe legjitimitimin e rregulloreve të brendshme të dala në bazë të këtij Statuti<sup>9</sup>.

Bazuar në përcaktimet ligjore sipërcituar, rezulton se Kryesia e ASH-së vepron si organ ekzekutiv i Akademisë.

Nga parashtrimet e kërkimet e ankuesit lidhur me mospagimin e pagës në masën e plotë, por në masën 20% si dhe pagimin e sigurimeve shoqërore mbi bazën e pagës 40 000 lekë, si dhe bazuar në këqyrjen e akteve e provave bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vëren se, nuk rezulton që trajtimi i mësipërm (masa e pagës dhe sigurimeve shoqërore) të ketë ardhur nga ndonjë veprim apo vendimmarrje e Kryesisë së ASH-së.

Në kontekst të legjitimitimit të ankuesit kundrejt subjektit ndaj të cilit ka pretenduar diskriminimin, *Komisioneri vëren se*, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe "Statuti i ASH-së", Kryesia e ASH-së nuk gëzon legjitimin pasiv për pretendimin e ankuesit për diskriminim lidhur me caktimin e masës së pagës apo të sigurimeve shoqërore, pasi nuk ka tagrin për përcaktimin sa më sipër.

Për më tepër, kërkimet e ankuesit janë të përcaktuara në Akt-Marrëveshjen e nënshkruar mes tij dhe ASH-së, përfaqësuar nga Kryetari i saj, S. Gj. Ndaj, dhe formalisht, këto pretendime kundërdrejtohen ndaj ASH-së, përfaqësuar nga Kryetari i saj dhe jo ndaj Kryesisë së ASH-së, pasi kjo e fundit, nuk ka kryer si organ kolegjal ndonjë veprim apo vendimmarrje i cili ka sjellë pasoja tek ankuesi.

Për rrjedhojë, në këtë këndvështrim, Komisioneri vlerëson se, Kryesia e ASH-së, nuk gëzon legjitimin pasiv në këtë proces para KMD-së.

Së treti, Komisioneri vëren se, në thelb, pretendimet e ankuesit lidhen me përmbajtjen e Akt-Marrëveshjes me nr. 515/1 prot., datë 24.05.2024, lidhur mes tij dhe ASH-së, përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. S. Gj, specifikisht pikës 2, të saj.

Kjo Akt-Marrëveshje përbëhet gjithsej nga 5 pika, dhe në thelb ka të bëjë me:

- Ruajtjen e vendit të punës së ankuesit për periudhën 3 qershor 2024 - 31 mars 2026, që përkon me kohën e largimit jashtë vendit të ankuesit në kuadër të bursës Humboldt, dhënë nga Qeveria e RF Gjermane;

<sup>8</sup> Ndryshimi i fundit bërë me Vendimin e Asamblesë nr. 21, datë 23.02.2024.

<sup>9</sup> Neni 1, i Statutit të ASHSH: "Objekti/Qëllimi".

- Trajtimin financiar të ankuesit në masën 20% të pagës për periudhën e mësipërme kohore.

Kjo Akt-Marrëveshje (që tani kontestohet vetëm për masën e pagës) është lidhur me vullnet të plotë e të lirë të ankuesit. Nuk rezulton dhe as pretendohet që kjo Akt-Marrëveshje të jetë lidhur ne kushtet e lajthimit, kanosjes, apo të jetë e vesuar.

Ankuesi është person madhor, i përgjegjshëm para ligjit, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, dhe për më tepër, referuar statusit të tij: kërkues shkencor Ph. D, në Akademinë e Shkencave, plotësisht i aftë për të kuptuar, arsyetuar dhe nënshkruar duke kryer veprime juridike. Pretendimi i ankuesit se nuk kishte kohë të studionte përmbajtjen e Akt-Marrëveshjes së datës 24 maj 2024, është haptazi i pabazuar, referuar faktit se, kjo Akt-Marrëveshje përmbante dy elementë thelbësorë:

- dhënien e lejes për ankuesin dhe ruajtjen e vendit të punës (për të cilën ankuesi është dakord);
- si dhe, pagesën e tij me 20% të pagës për periudhën e mësipërme kohore (pikë me të cilën tani, ankuesi nuk është dakord).

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ndodhemi përpara rastit, kur ankuesi ka pretenduar për paligjshmëri të Akt-Marrëveshjes së nënshkruar mes tij dhe ASH-së, (pa përcaktuar se cili ligj apo akt nënligjor specifikisht është shkelur apo cili duhet zbatuar), në lidhje me masën e trajtimit financiar (pagës dhe sigurimeve shoqërore) që duhet të përfitojë një kërkues shkencor pranë ASH-së, kur trajtohet me bursë nga një Qeveri e huaj, Fondacion, Universitet i huaj etj. Për rrjedhojë, çdo kërkesë a pretendim i ankuesit lidhur me këtë çështje (kërkimin e pagës dhe sigurimeve shoqërore, sipas pretendimeve të tij) duhet paraqitur në rrugë gjyqësore.

Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se një shqyrtim i tillë, nuk bën pjesë në kompetencat lëndore dhe fushën e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për pasojë, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse:....., është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, kërkimet e subjektit ankues lidhur me ndryshimin e pikës 2, të Akt-Marrëveshjes me nr. 515/1 prot., datë 24.05.2024, lidhur me masën e pagës, nuk mund të pranohen dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohen procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 12/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3/c dhe 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

- 1.** Mospranimin e ankesës të paraqitur nga shtetasi A. H, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**